



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 11.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: në proces
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"— projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Kolegji I Posacëm I Apelimit (këtu e më poshtë KPA). Objekti: Shqyrtimi I ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, kundër vendimit nr. 22, dt. 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Edmond Islamaj.		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar në Gjykatën e Lartë.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca dëgjimore publike, u zhvillua në intervalin kohor 11:30-12:41, dhe u shty 6 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore.. Shtyrja e seancës është objektivihtë e arsyeshme për shkak të specifikës së çështjes, faktit që shqyrtohet në instancën e fundit ankimore vendimi i formës së prerë të së cilës krijon res judicata, kompleksitetit të çështjes, numrit të lartë të akteve provuese të kërkuara për administrim nën efektin e provës nga të dyja palët, si edhe pretendimeve të shumta paraqitur nga Komisioneri publik për riadministrim të provave administruar jo saktësisht nga KPK dhe administrim të akteve provuese të pamarras parasysh nga KPK.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Seanca u shty në dt. 17 dhjetor ora 12:00, me qëllim për ti dhënë kohën për studim palëve (subjekt i rivlerësimit-komisioneri publik) në lidhje me vlerën provuese të disa akteve të tjera zyrtare dërguar nga institucionet shtetërore të pyetura, për llogari të provave të kërkuara nga Komisioneri		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Tupa gjykyese (emrat)	Luan Daci - Kryesues I trupit gjykues; Sokol Como - Relator i çështjes; Albana Shtylla, Ina Rama dhe Rezarta Schuets - anëtarë të trupit gjykues; te pranishem gjate gjithë kohes		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit z. Ferdinando Buatier de Mongeot; I pranishem pa shkëputje deri në përfundim të seancës dëgjimore.		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht nga subjekti i rivlerësimit.		
Pala ankimuese (Komisionerët Publik/Subjekti i rivlerësimit) (gjeneralitetet)	Komisioneri Publik referues I çështjes: z. Florjan Ballhysa		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri I anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 20 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën degjimore. Akomodimi u krye ne formë të rregullt nga stafi menaxhues I KPA, pavarësisht hapësirës së kufizuar të sallës.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 1 përfaqësues, me akses të plotë ne hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median".		

C. A vendosi pala ankimuese të parashtror pretendime për të tre kriteret ligjore të Vettingut?	Po/Jo	Në cilat prej tre kriterëve ligjore u ndalua pala ankimuese (komisionerët publik) në prezantimin e shkaqeve të pretendimeve? Specifikoni kërkesat përfundimtare (pretendimet).	Cili është reagimi i subjektit të rivlerësimit ndaj pretendimeve të Komisionerit publik? Specifikoni kërkesat përfundimtare (prapësimet). Specifikoni nëse ka bërë Apel kundërshtues.
	jo	Pala ankuese, përbërë nga dy komisionerët publik, pretendoj se janë konstatuar mangësi në gjëndjen që janë aktet, sa i takon vlerësimin të pasurisë të subjektit të rivlerësimit. Kërkesat përfundimtare të parashtruara: riceljen e hetimit administrativ, me qëllim riadministrimin e provave administruar në formë të pasaktë nga KPK, dhe administrimin për herë të parë të akteve provuese të paadministruara në hetimin administrativ kryer nga KPK.	Subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij duke e cilësuar vendimin e KPK të drejtë, dhe duke kërkuar përfundimisht "lënien në fuqi të vendimit të KPK, që ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë". Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti apel kundërshtues. Deklaroj se ka marrë dëni për Vendimin e ankimit dhe shkaqet e ankimit
D. Përbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Prezantimi i pretendimeve/prapësimeve	pala që ka parashtruar pretendimin	A u diskutua? Specifikoni aktet provuese të administruara? Specifikoni barrën e provës ?
D1. Pasuria	Komisioneri publik pretendoj se vendimi i ndërmjetëm i trupës gjyqësore me objekt: pranimin e kërkesës së komisionerit publik, lidhur me riceljen e shqyrtimit gjyqësor, nuk është paraqitur në formë zyrtare dhe të arsyetuar nga Kolegji. Për këtë nuk kuptohet nëse aktet e paraqitura në seancën e sotme mund të vlerësohen dhe administrohen apo jo. Në qëndrimin e tij, duhej deklaruar se kjo fazë procedurale lidhur me administrimin e provave të paraqitura nga trupa gjyqësore, përbënte veprim ex officio në kuptim të N.45 të ligjit 84/2016, apo ekzekutohet konform kërkesës së Komisionerit për marrjen e këtyre shkresave në efektin e provës.	Komisioneri Publik	Provat e administruara në seancën dëgjimore: 2 harta treguese. Pozita procedurale e Komisionerit Publik, i rezervon të drejtën të paraqes kërkesë për marrjen e provave që nuk janë administruar nga KPK, pa pasur barrën e provës për të vërtetuar pretendimet e tij.
	Prapësoj lidhur me pretendimin e komisionerit, duke argumentuar se fakti që seanca ka procedur me administrimin e provave presupozon vendimmarrjen e Kolegjit.	Subjekti i rivlerësimit	Aktet provuese të paraqitura në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit: 1. Kontratë shitblerje me A.H, 2010, për P.P. të llojit "kullotë", dhe certifikatë pasurie 2. Kopje kërkesë të thjeshtë, ku palët kanë paraqitur vullnetin e tyre për ndarjen e pasurisë. 3. tre foto të pasurisë së mësipërme, për të treguar gjëndjen e saj. 4. Kopje mandat pagese të një pjese të paguar të vlerës së një prej autoveturave. 5. Analizë e veprimeve të klientit shpk, automjetin e të cilës ka poseduar me policë sigurimi. 6. Vërtetim pune të shoqatës ku ka punuar bashkëjetuesja e tij, pa datë. Dhe letër rekomandimi 7. Udhëzim nga Ministria e Drejtësisë për heqjen e licencës së noterit, të të atit. 8. Leja e ushtrimit të avokatit të të atit 9. Certifikatë personale e familjare 10. Vërtetim ZRPP të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ndërtesë dhe truall, dhe garazh 11. Deklaratë nga të afërmit për financim të njërit prej udhëtimeve jashtë shtetit. 12. Regjistrim i ushtrimit të aktivitetit si përkthyespër llogari të bashkëjetueses 13. Vërtetim pune kryer nga bashkëjetuesja në një OJF, pa përcaktuar pagën.
	Subjekti i rivlerësimit përfaqësohet personalisht	Mbrojtja	

	Deklaroj se vendimi I ndërmjetëm është në funksion dhe pasojat kanë ardhur në seancat në vazhdim. Trupa gjykuese paraqiti një liste dokumentash (shkresa përcjellëse) ardhur nga institucionet shtetërore, sic ishin kërkuar nga Komisioneri Publik	Relatori	
		Ankesa nga publiku	
		Perfaqësuesi I ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Subjekti I rivlerësimit përfaqësohet personalisht	Komisioneri Publik	
		Mbrojtja	
		Subjekti I rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës		Perfaqësuesi I ONM	
		Komisioneri Publik	
	Subjekti I rivlerësimit përfaqësohet personalisht	Mbrojtja	
		Subjekti I rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
		Perfaqësuesi I ONM	
<b>monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</b>	Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Kohëzgjatja e seancës publike prej 1 orë e 10 min, justifikoj ndërprerjen e seancës për një pushim prej 40 minutash, kohë në të cilën trupi gjykues u tërhoq për mbajtjen e një qëndrimi lidhur me pretendimet e Komisionerit. Elementet procedural të procesit gjyqësor, referuar nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, janë respektuar. Seanca gjyqësore u shty me argumentimin e kohës që i duhet palëve në proces për të mbajtur një qëndrim mbi vlerën e provave të paraqitura në seancë nga trupi gjykues (marrë nga institucionet publike të pyetura). Lidhur me sa më sipër, Komisioneri replikon duke pretenduar se provat e paraqitura në këtë seancë gjyqësore nga ana e trupës gjykuese nuk i përgjigjen listës së plotë të akteve të kërkuara nga kjo palë, për këtë kërkoj sqarim nëse këto akte janë përkthim i ankimit të paraqitur apo hetim kryesisht, ex officio, i Kolegjit. Kundershtimi i komisionerit konsistonte në aktet e paplota të siguruar nga kolegji, pasi, komisioneri, referuar rregullimit ligjor, nuk ka detyrim të provoj pretendimet e tij, por i kërkon kolegjit, të marrë një nr të caktuar aktsh, që ai i koncepton me vlerë për provimin e pretendimeve të tij. Në kete katgori aktesh të kerkuara, dhe te parashtruara ne seance nga kolegji, nuk ishin marre disa nga aktet qe komisioneri kishte kerkuar, dhe qe per kete pretendon qe jane te paplota. Kolegji, do te merret me aktet e mbetura ne seancat ne vijim.		